



MEETING MINUTES

ZBARDHJE E MINUTAVE NGA TAKIMI I *ANTARËVE TË BORDIT EITI*

12 SHKURT 2021

11:00 AM

NË PLATFORMËN ZOOM

LIST PREZENCA

Z. GENCI TERPO DREJTUES I SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI

ZNJ. MIMOZA SALLAKU MINISTRIA E FINANCAVE

Z.PERPARIM ALIKAJ FIAA

Z.BILAL KOCI SHGJSH

Z.LORENC GORDANI SHOQËRIA CIVILE

Znj.OLA MITRE SHOQËRIA CIVILE


Z. SAMI NEZA SHOQËRIA CIVILE

Z.KUSHTRIM SIMONI SHOQËRIA CIVILE

Z.LLUKA GJERGJO SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI

ZNJ.EMILIANA KOLA SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI

FOTO NGA TAKIMI I MSG-së



Z. Genci Terpo Përshëndetje, uroj të jeni mirë! Siç e dini kjo është mbledhja e parë e MSG-së për vitin 2021. Viti që kaluam ishte një vit relativisht me punë por dhe një vit i veshtirë. Ajo çka është për tu theksuar është se EITI ka qënë gjithmonë aktiv, ku kemi laboruar një numër të madhë projektesh, projekte që kanë qënë në planin e punës për vitin 2020. EITI arriti ti realizonte këto projekte në afatin e caktuar duke respektuar dhe afatet që përcakton background-i i Bankës Botërore për implementimin e tyre. Si ju kemi vënë ne dijeni dhe më pare, u munduam të realizonim projektet në një kohë të shkurtër dhe realisht është për tu falenderuar dhe ndihma që na ka dhënë MSG-ja.

Unë shkurtimisht do t'ju përshkruaj një listë të të gjithë projekteve me të cilat ne patëm mundësi të punonim gjatë këtij viti.

Raporti EITI 2017-2018, një projekt i cili është shumë i rëndësishëm për EITI-in ku normalisht pati vështirësit e veta kjo sepse gjatë periudhës së pandemis një nga ato sektor që u prek në vendin tonë por dhe në botë ishte sektori minerar. Kjo solli dhe vonesa nga subjekte të cilat për shkak të situatës përkatëse u vonuan në raportim, megjithatë ne ju drejtuam Sekretariatit në Oslo disa herë dhe për shtyrjen e afatit. Po arritëm ta realizonim këtë projekt brënda afatit të caktuar, pra brënda kushteve të zbatimit të kontratës me kompanin audituese Deloitte e cila ishte dhe konsulenti për realizimin e raportit të EITI.

Një ndër projektet e tjera që ne e realizuam ishte studimi i impaktit mjedisor në fushën e industrisë nxjerrëse. Lidhur me këtë projekt u angazhua kompania Abcons e cila realizoi produktin në kohë dhe u bë dhe një prezantim përsa i përket këtij studimi.

Projekt tjetër që u zhvillua në kohë shumë të shpejt, kjo fal dhe bashkëpunimit që patëm me institucionet si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKBN, ishte projekti i realizimit të Kadastrës Minerare i realizuar në kohë rekord dhe mund të gjendet në faqen zyrtare të EITI-it Shqipëri.

Projekti rradhës ishte projekti për realizimin e portalit Open Data i zhvilluar brënda kushteve dhe kriterëve. Portali është i aksesueshëm nga të gjithë ku ka informacione për fushën e industrisë nxjerrëse.

Një rolë mjaft të rëndësishëm në gjithë procesin mediatik të EITI-it luajti dhe ambasadori i EITI-it, i cili në mënyrë mjaft aktive gjatë këtij viti është munduar maksimalisht të realizoj takime për sa i përket aktivitetit të EITI-it në Shqipëri.

Këto ishin me pak fjalë disa nga ato projekte që ne realizuam për një periudh të shkurtër kohe duke filluar që nga qershori i vitit 2020 deri në dhjetor të vitit 2020, u munduam ti realizonim megjithëse në kushte të vështira.

Nuk e di nëse ndonjë nga antarët e MSG-së ka ndonjë gjë për të shtuar, në të kundërt vazhdojmë me pikën e dytë për këtë mbledhje.

Znj. Ola Mitre Me fal vetëm një ndërhyrje të shkurtër se do më duhet të largohem

Z. Genci Terpo Po patjeter!

Znj. Ola Mitre Duke qënë se në fund u përmend pjesa e aksesit të të dhënave në Portal, do të doja të sygjeroja që janë disa të dhëna sikurse përshembull rregjistrin mineral, përveçse është shumë i vjetër, tani nuk mund të aksesohet. Do doja që këto të dhëna të ishin pak më lehtësisht të aksesueshme dhe pak më të rinovuara.

Z. Lluka Gjergo Ola për të sqaruar shumë shpejt, do e kemi dhe rregjistrin mineral 2020 por për sa i përket është i aksesueshëm apo jo nuk mund të them, kjo sepse faqja u modifikua dhe ka sjell probleme të cilat do rishikohen.

Znj. Ola Mitre Dakort shumë faleminderit.

Z. Sami Neza Në lidhje me vendimet që janë marrë për ligjet ndaj taksave a është pyetur EITI për sa i përket këtyre ndryshimeve si përshembull në rastin e rentës minerare.

Z. Genci Terpo Ne jemi angazhuar në projektin e OSBE për sa i përket çështjes së rentës minerare por nuk është se kemi dhënë ndonjë koment ose jemi pyetur për këto ndryshime.

Z Sami Neza Ndryshimet që janë bërë në lidhje me taksat kanë ndryshuar të gjitha përpjekjet e EITIT, OSBE dhe disa projekteve të shoqërisë civile në lidhje me rentën minerare. Janë në kundërshtim me të gjitha rekomandimet që janë dhënë në këto projekte dhe unë çuditem sesi përjashtohet Sekretariati EITI ose MSG-ja nga një marrje vendimi e rëndësishme në lidhje me menaxhimin e burimeve natyrore.

Z. Genci Terpo Për shkak ndoshta dhe të situatës pandemic, instancat e përcaktuara kanë vendosur që mos të ketë ndonjë zhvillim dhe ndonjë diskutim më i gjerë përse i përket këtyre vendimarrjeve.

Znj.Ola Mitre Unë kam patur mundësin që të ndjek diskutime që janë bërë në Kuvend për miratimin e ndryshimeve dhe Zëvendësministri pavarësisht se është Kryetar i MSG-së në komisione ka propozuar që renta të zerohet për të gjitha kompanitë.

Z.Sami Neza Kjo gjë s'është normale pasi është një prej çështjeve më të rëndësishme të EITI-it dhe MSG-së. Është një rast i përsëritur nga 2013-2014 kur u bë ndryshimi për Ligjin Minerar dhe ne s'është nuk jemi pyetur dhe kjo tregon që MSG-ja duhet të pozicionohet në një far mënyre, të mbajë një qëndrim, kjo më shumë për efektivitetin e vet MSG-së, jo thjesht për raportet me Qeverinë.

Znj. Ola Mitre Është e vertet.

Z.Sami Neza Une kaq kisha, z. Genci dhe ju kupto, megjithatë mendoj që në takimet që ju do keni me institucionet përgjegjëse, Ministrinë e Energjitikës, ju duhet ti përcillni këtë shqetësim. Ne jemi shumë të shqetësuar dhe nuk jemi ndier shumë dhe për shkak të këtyre kufizimeve pandemike por ky realisht është një problem. Kjo tregon se ne si MSG dhe ju si Sekretariat jemi shumë të papërfillshëm në vendimarrje.

Znj.Ola Mitre Ndoshta mund të sygjeroj diçka tjetër duke qënë se ligji tani është miratuar dhe botuar në fletoren zyrtare. Po të lobohet që për pjesën e Bashkive, të bëhet ai rimbursimi i pjesës së munguar që ata do të kenë, pasi për ata kjo është shumë e rëndësishme. Gjatë propozimeve në komision në fakt u përmend disi kjo pjesë por u la e pa miratuar.

Ndoshta në pamundësi të ndryshimit të vet ligjit mund të bëjmë disa propozime, ta transformojmë disi këtë ligj.

Z.Genci Terpo Ideja është se nuk kemi patur një koment për sa i përket ligjit. Z Bejtja është Kryetar i MSG-së Ola por nuk është një iniciativë e zotit Bejtja, propozimi i ligjit. Do ishte mirë që zoti Bejtja të ishte prezent sot. Ky ligj ka një impakt të caktuar, megjithatë ndoshta nuk është ky momenti që ne të japim komente dhe të trajtojm çështje të caktuara të këtij ligji. Ndoshta mund të bëjm një mbledhje të posaçme për këto çështje.

Znj. Mimoza Sallaku Me falni nëse mund të bëj një saktësim për çka u fol deri tani. Taksa e rentës minerare nuk është zeruar për të gjitha por vetëm për eksportin, ndërsa për prodhimin vendas taksa e rentës vazhdon të paguhet rregullisht edhe gjatë vitit 2021.

Z.Lluka Gjergo Po minerali i cili nuk përpunohet por eksportohet a taksohet?

Znj. Mimoza Sallaku E cilësoj dhe njeherë tjetër, taksa e rentës minerare për prodhimin vendas që shitet brenda vendit nuk është zeruar.

Z.Lluka Gjergo Qartë, kjo është e kuptueshme por materiali i cili përpunohet, shitjen e ka jashtë dhe une pyes se jemi të paqartë të gjithë në këtë situatë, një mineral që del me përqindje të pranueshme në eksport paguan rent apo jo?

Znj.Mimoza Sallaku Në eksport nuk paguan.

Z.Lluka Gjergo: Ai minerali pa u përpunuar, pa u futur domethënë, pa u futur në ato uzinat e ferrokromit ai taksohet apo jo?

Z.Mimoza Sallaku Po duhet parë ligji i Doganës. Për ta ndar se cili mineral i përpunuar apo jo taksohet duhet komunikim me përfaqësuesit e Doganës.

Z.Genci Terpo Ndoshta do ishte më e mira që ne përpara se të diskutojmë për sa i përket kësaj çështje të marrim informacionet e duhura, pastaj pasi të njihemi hollësisht me çështjen mund të japim komente më të qarta.

Ok, atëhere mund të kalojmë te pika e radhës që është diskutimi i Planit të Punës të ALBEITI-it 2021-2022.

Drafti i punës i dërguar nga znj.Emiliana parashikon një plan pune 2 vjeçar. Jemi munduar të përfshijmë element kryesor. Mendoni ti listoj me rradhë këto element apo të ndalojm të komentojm ndonjë element specifik.

Z.Kushtrim Simoni Unë mendoj kush ka ndonjë gjë për të shtuar, më mirë sesa ti listojm me rradhë.

Z.Genci Terpo Ky është një Plan Pune që ka mundësi financimi dhe donatorësh. Me aq sa keni pare, mendoni se ka një aktivitet që nuk duhet gjatë këtyre 2 viteve. Këto janë aktivitete krejtësisht të reja.

Z. Përparim Alikaj Unë kam një pyetje. A ka ndonjë zë, përshebull, është aprovuar nga Banka Botërore dhe akoma nuk ka gjetur zbatim, jo vetëm nga EITI kam parasysh dhe Ministrin në probleme të ndryshme të industrisë minerare. Kam parasysh gjeofizikën ajrore për të cilën mbaj mend në takimet që pata me përfaqësuesit e Bankës Botërore janë kërkuar 15 milion dollarë. Duhet patur parasysh që gjeofizika ajrore është shumë e rëndësishme në Shqipëri dhe ska pas ende një projekt të mirëfillt. Ne duhet ti kërkojm Bankës Botërore për këtë projekt, në rast të kundërt këto para janë të humbura.

Z.Genci Terpo Profesor, unë do të pyes për rastin në fjalë. Nuk kam një informacion të saktë. Natyrisht ajo që trajtoni është e rëndësishme por smund të jap një përgjigje. Dakort atëhere përsa i përket planit të punës ka ndonjë koment.

Z. Përparim Alikaj Dakort jemi.

Znj. Emiliana Kola Mund ta bëj një sqarim në lidhje me Planin e Punës. Ne kemi parashikuar që në vijim, në grantin në vijim të ketë një sasi fondesh për aktivitete të shoqërisë civile. Duke qënë se ne akoma si kemi të qarta burimet e financimit të grantit nuk e dimë nëse do jetë e mundur që kjo të bëhet nga Banka Botërore. Nuk e di nëse antarët e shoqërisë civile e kanë parë këtë pikë dhe kanë ndonjë koment.

Z. Sami Neza E kam parë unë këtë pikë po nuk doja ta diskutoja pasi më duket e supozuar si pikë. Ne kemi 10 vjet që negociojmë me Banken Botërore që të negociojë një fond për

shoqërinë civile dhe asgjë. Arsyeja është se janë të përfaqësuara nga MSG, justifikim i pa argumentuar.

Znj.Emiliana Kola Në planin e punës është e specifikuar shuma që është parashikuar për shoqërinë civile.

Z. Sami Neza Po është por ju nuk e keni të sigurt mbështetjen nga Banka Botërore.

Z.Genci Terpo Një pikë tjetër që ne kemi si diskutim është mundësit e financimit nga kompanitë private në fushën e industrisë nxjerrëse. Z Ilir Bejtja e ka trajtuar si pikë ku dhe neve si institucion mund tu dërgojm një letër ku të na ndihmojn nga ana financiare për projektet që kemi në vijim të viteve.

Z. Përparim Alikaj Ne duhet tu dërgojm jo letër standarte por letër për çdo kompani ku të diferencohet për çdo kompani letër të veçant.

Z.Genci Terpo Dakort profesor, faleminderit do të bëjmë letra të diferencuara për secilën kompani dhe brënda këtij muaji do ti kemi përmbyllur. Unë ju falenderoj për mbështetjen që na jepni.

Nuk e di nëse ka ndonjë koment tjetër dhe nëse nuk ka mendoj që mbledhja e arriti qëllimin.